


Raporti final për konsultimin publik për draft rregulloren për Transparencë në Komunën e Malishevës dhe Planin e Veprimit për Transparencë 2025-2029



REPUBLIKA E KOSOVES



KOMUNA E MALISHEVES

TRANJUAR ME
ACCEPTED ON
VESEL KRASIQI

29/10/2024
01/1122

Kryetari i Komunës

Nr. 01/

Datë: 28/10/2024

Mbështetur në nenin 13, 24 dhe neni 58 (shkronja a,b, f dhe g) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale (Ligji nr.03/L-040) dhe në pajtim me Statutin e Komunës së Malishevës, dhe kërkesës së Njësisë për Komunikim Publik nr.01/1104, dt.23.10.2024

Kryetari i Komunës me datë 28.10.2024 mori këtë:

VENDIM

PËR FORMIMIN E GRUPIT PUNUES

I. Miratohet, kërkesa nr.28/1104 të datës, 23.10.2024, e parashtruar nga Njësia për komunikim publik, për formimin e grupit punues për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për Transparencë Komunale dhe Strategjisë Komunale për Komunikim si dhe Planin e Veprimit për transparencë, për periudhën kohore 2024/2029, për Komunën e Malishevës.

I I. Grupi Punues i formuar sipas nenit I të këtij vendimi, do të jetë në përbërje prej nëntë (9) anëtarësh me emrat e poshtëshënuar;

- 1. Vesel Krasniqi-Nënkryetar i Komunës -Kryesues i grupit,
- 2. Argjend Thaqi-Kryesues i Kuvendit-anëtar,
- 3. Fatmir Ademaj- Drejtori i drejtorisë për administratë-anëtar,
- 4. Blerim Thaqi-Drejtor i drejtorisë për financa dhe bugjet-anëtar,
- 5. Muharrem Morina- anëtar,
- 6. Bardhyl Buçaj- anëtar,
- 7. Izet Shala-anëtar,
- 8. Artan Paçarizi-anëtar,
- 9. Valmir Gashi-anëtar.

I I I. Ky grup është i obliguar të zbatojë procedurat administrative në lidhje me ndryshimin dhe plotësimin e dokumenteve publike të komunës së Malishevës, si Rregullores për Transparencë Komunale dhe Strategjisë Komunale për Komunikim si dhe Planin e Veprimit për transparencë, për periudhën kohore 2024/2029, pastaj të njëjtat draft dokumente do të procedohen konform kërkesave ligjore, deri në procedurën përfundimtare.

I V. Ky vendim hyn në fuqi me datë, 28.10.2024.

Kryetari i Komunës
Ekrem Krasniqi



Vendimi ju dorëzohet:

1. Grupit Punues,
3. Arkivit të komunës.

Datë, 29.10.2024
Nr i prot.01/1122

- Komuna e Malishevës përmes ekipit punues për hartim të **Projekt- RREGULLORE PËR TRANSPARENÇË, 2025-2029**, duke u bazuar në Ligjin Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, Ligji Nr. 06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike; Ligji Nr.06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale; Udhëzimin Administrativ (MAPL) Nr.04/2023 për Administratë të hapur; 1.6 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 06/20218.
- Statutin e Komunës së Malishevës dhe Nenin për Konsultime Publike, Rregullores për Transparencë të Komunës së Malishevës

NJOFTIM PËR KONSULTIM PUBLIK

Lidhur me konsultimin e **Projekt- RREGULLORE PËR TRANSPARENÇË, 2025-2029**, ky dokument do të jetë në konsultim publik nga data 1.11.2024 deri me datën: 30.11.2024.

Komentet dhe propozimet e juaja mund t'i dërgoni deri, më datën 1.11.2024 DERI MË 30.11.2024, në ora 16:00 tek përgjegjësit, në formë fizike ose në e-mail adresat e zyrtarëve përgjegjës: komuna.malisheve@rks-gov.net, kkmalisheve@gmail.com, artan.pacarizi@rks-gov.net, , blerta.d.krasniqi@rks-gov.net,

Për më shumë detaje për **Projekt- RREGULLORE PËR TRANSPARENÇË, 2025-2029 DHE DOKUMENTET PËRCJELLËSE PLAN DHE STRATEGJIA**, mund ta gjeni në linkun e ueb faqes zyrtare të Komunës së Malishevës: <https://kk.rks-gov.net/malisheve/category/dokumente/konsultime-publike/> , si dhe në platformën online të konsultimeve publike: <https://konsultimet.rks-gov.net/>

Malishevë, 1.11..2024

Izet Shala
Udhëheqës i Njesisë për Komunikim Publik.

Procesverbal nga takimi konsultativ për Draft- Rregulloren për Transparencë dhe dokumentet përcjellëse

Malishevë, 26 nëntor

Procesverbal nga mbledhja e parë e komisionit për Plotësim Ndryshimin e Rregullores për Transparencë dhe hartimin e Planit të Veprimit për Transparencë 2025-2029

Komisioni i formuar nga Kryetari i Komunës, me datë **15.11.2024** e ka mbajtur mbledhjen e parë. Mbledhja e komisionit është drejtuar kryesuesi i komisionit, nënkryetari i komunës, Vesel Krasniqi.

Në fjalën e tij, kryesuesi i komisionit, i vlerësoi si shumë të rëndësishme të dy dokumentet që lidhen direkt me transparencën e komunës dhe plotësimin obligimeve ligjore që në këtë rast, ka komuna dhe i ftoi të gjithë anëtarët e komisionit të japin opinionet e tyre, sidomos në aspektin juridik.

Më pas, draftet e rregullores të planit të veprimit, i ka prezantuar anëtari i komisionit, Izet Shala, shef i njësisë për Komunikim me Publikun.

Anëtari i komisionit, Muharrem Morina, zyrtar ligjor i komunës, tha se dokumentet janë të sponsorizuara nga kryetari i komunës dhe duhet të ndiqet procedura, ku së pari bëhet plotësim ndryshimi i rregullores për transparencë, e më pas hartohet Plani i Veprimit.

Kryesuesi i Komisionit, ka thënë se pas përfundimit të miratimit të rregullores, e që më pas lidhet edhe me planin e veprimit, duhet që të gjitha njësitë përkatëse të komunës ti zbatojnë obligimet që dalin nga këto dokumente. Po ashtu, ai the se këto dokumente dhe zbatimi i tyre lidhet ngushtë edhe me matjen e performancës së komunës, sidomos në fushën e transparencës dhe gjithashtu, duhet të fillohet edhe me zbatimin e dygjuhësisë, qoftë edhe me përkthim digjital.

Anëtarët e komisionit, i kanë dhënë disa sugjerime për të dy dokumentet, me qëllim që dokumentet që prodhohen të jenë të zbatueshme dhe obligative.

Kryesuesi i komisionit, Vesel Krasniqi, kërkoi nga Zyra për Informim Publik, që të përgatis edhe mbledhjen tjetër dhe më pas të mblidhen të gjitha komentet dhe mendimet e anëtarëve të komisionit, në mënyrë që dokumenti të jetë sa më i mirë, i zbatueshëm dhe në funksion të rritjes së transparencës komunale.

Procesmbajtësi: Artan Paçarizi





Në këtë takim për Draft- Rregulloren për Transparencë dhe dokumentet përcjellëse ku u kryesua nga Kryesuesi i Kuvendit Komunal, **Argjend Thaçi**, dhe sponsorizuesi i dokumenteve, Njësia e Komunikimit Publik, asistuan edhe përfaqësuesit nga OSCE, për Komunën e Malishevës, Salih Elshani dhe Sead Raba.

Të pranishëm ishin edhe përfaqësues të mediave, OJQ-ve lokale, zyrtarë të ekipit komunal, drejtorë të drejtorive dhe përfaqësues të sektorëve .

Salih Elshani nga OSCE ofroi mbështetje të praktikave më të mira për zbatimin e përgjegjësiive të Rregullore dhe Planit të Veprimit për Transparencë, nga institucionet komunale, që nga ekzekutivi, kuvendi, drejtoritë dhe sektorët si dhe rëndësinë që shfaq transparenca për zgjidhjen e problemeve të qytetarëve si dhe pjesëmarrja e tyre në vendimmarrje

Ndërsa përfaqësuesi nga Zyra për Komunikim me Publikun në Komunën e Malishevës, Izet Shala, tregoi për procedurat që ka kaluar drafti i rregullore për transparencë, si dhe ndryshimet e



plotësimet që do të funksionalizohen me shtimin e disa ligjeve dhe udhëzimeve në këtë draft-rregullore, ku do të ndikojnë në efikasitetin e përmbushjes ligjore dhe llogaridhënies.

Më pas u hap debat për diskutime, rreth dokumenteve në fjalë.

Enver Mazreku, tha se është tejet e rëndësishme, që kjo rregullore me palë në të veprimit dhe strategji për komunikim, t'i funksionalizoi tërë sektorët e administratës komunale si ato nga ekzekutivi , po ashtu edhe ato të vendimmarrjes, kuvendit, vetëm në këtë mënyrë të efikasitetit ia arrijmë t'i përmbushim detyrat dhe kriteret e afatet ligjore si administratë komunale në shërbim të transparencës, qytetarëve dhe zbatimit ligjor.

Alban Hoti, nga portali Malisheva post, kontribuoi me kërkesën për bashkëpunim në informimin që bënë NKP dhe mediat elektronike lokale për informim të qytetarëve, qëllimi i të cilit është i rëndësishë së veçantë për të gjitha zhvillimet të komunitetit deri në vendimmarrje për një klimë më të mirë në fusha të ndryshme për mirëqenien e qytetarëve deri të zhvillimi ekonomik lokal.

Në fund u kërkua nga të gjithë përgjegjësitë e institucioneve komunale , drejtorë dhe sektorë, që për së cilin dokument të interesit publik të zhvillohen procedurat e konsultimit publik dhe të respektohen kërkesat e qytetarëve si dhe të mos tejkalojnë afatet kohore ligjore edhe nga vet institucionet përgjegjëse publike.

Vërejtje: Pjesëmarrësit nuk kanë asnjë koment propozim për ndryshime në draftin e propozuar. Gjithashtu, nuk kemi marrë asnjë koment për ndryshime gjatë periudhës sa ka qenë drafti në konsultim publik.

Malishevë, 26.11.2024.

Procesmbajtësi: Artan Paçarizi